

Pranuar me dt 04.05.2015			
Njesia org	Numer	Nr ekzempl	Vlera
	467		



UNIVERSITETI I MITROVICËS "ISA BOLETINI" MITROVICË  
UNIVERSITY OF MITROVICA "ISA BOLETINI" MITROVICA

Adresa: Parku Industrial, p.n

[www.umib.net](http://www.umib.net)

Tel: +381 28 535 725 / 535 727

Në bazë të nenit 49, paragrafit 1, nënparagrafit 3, të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", Senati i Universitetit, sipas propozimit të Fakultetit Juridik, në mbledhjen e mbajtur më 15.4.2015, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR STUDIMET THEMELORE – BACHELOR

**Dispozitat përgjithshme**

**Neni 1**

Me Rregulloren për studime themelore- bachelor (këtu e tutje: Rregullorja) rregullohet organizimi, forma dhe kohëzgjatja e studimeve, regjistrimi në studime, gjuha e studimeve, të drejtat dhe detyrat e studentëve, ndërrimi i programeve të studimeve, koha dhe mënyra e mbajtjes së provimeve, përfundimi i studimeve, si dhe çështje tjera që lidhen me studimet themelore në Fakultetin Juridik.

**Neni 2**

1. Fakulteti Juridik (këtu e tutje: Fakulteti) është njësi akademike në kuadër të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".
2. Fakulteti Juridik e ka selinë në Mitrovicë dhe ofron studime themelore 4 vjeçare, prej gjithsej 8 semestrave.

**Neni 3**

1. Studimet themelore – bachelor (këtu e tutje: studimet) organizohen dhe mbahen sipas plan-programit mësimor të miratuar nga Këshilli i Fakultetit.
2. Plani dhe programi mësimor mund të ndryshohet apo të plotësohet me propozim të Këshillit të Fakultetit.

### **Forma e studimeve**

#### **Neni 4**

1. Fakulteti organizon studime të rregullta dhe me korrespondencë.

### **Mënyra e realizimit të mësimit**

#### **Neni 5**

1. Mësimi realizohet përmes ligjëratave, ushtrimeve teorike, mësimit praktik, seminareve, kolokfiumeve, konsultimeve profesionale, punimeve të pavaruara të studentëve, si dhe vizitave me karakter mësimore – shkencor.
2. Lënda mësimore mund të ligjërohet me javë gjatë një apo dy semestrave ose mund të mbahet si bllok ligjëratash në një semestër.

### **Viti akademik**

#### **Neni 6**

1. Viti akademik fillon më 1 Tetor dhe përfundon më 30 Shtator të vitit vijues.
2. Semestri dimëror fillon më 1 Tetor dhe përfundon më 15 Janar të vitit vijues.
3. Semestri veror fillon me 16 Shkurt dhe përfundon më 31 Maj të vitit vijues.

### **Kohëzgjatja e studimeve**

#### **Neni 7**

1. Studimet zgjasin 4 vite, përkatësisht 8 semestra dhe përbëhen prej 240 kredive.
2. Studenti duhet që, për çdo vit të studimeve, të sigurojë nga 60 kredi nga provimet e dhëna në lëndët obligative dhe zgjedhore.

### **Fitimi i thirrjes akademike nga studentët**

#### **Neni 8**

Me përfundimin e suksesshëm të studimeve, studenti fiton thirrjen akademike JURIST I DIPLOMUAR – BACHELOR.

### **Programet e studimeve.**

#### **Neni 9**

1. Fakulteti ofron studime me programin Juridik i Përgjithshëm.
2. Programet e studimit përmbajnë:
  - 2.1. Titullin e studimit;
  - 2.2. Llojin e studimit;
  - 2.3. Thirrjen akademike (titullin akademik);
  - 2.4. Kushtet për regjistrim;
  - 2.4. Objektivat dhe rezultatet;
  - 2.4. Hollësitë mbi planprogramin;
  - 2.4. Kompetencën;
  - 2.5. Vlerën në pikë sipas kredive.
3. Në semestrin e 8-të, studentët janë të lirë të zgjedhin njërin nga këto module:
  - 3.1. Modulën e drejta administrative dhe kushtetuese;
  - 3.2. Modulën e drejta penale;
  - 3.3. Modulën e drejta civile;

- 3.4. Modulin e drejta ndërkombëtare;
- 3.5. Modulin e drejta financiare;
4. Studentët mund të zgjedhin vetëm njërin prej moduleve dhe për këtë duhet të përcaktohen me rastin e regjistrimit të semestrit të 8-të.
5. Pas zgjedhjes së modulit nga studenti, nuk lejohet më ndërrimi i modulit.

### **Gjuha e studimeve**

#### **Neni 10**

1. Fakulteti organizon studimet në gjuhën shqipe.
2. Me propozim të Këshillit të Fakultetit dhe vendim të posaçëm të Senatit, studimet mund të organizohen edhe në gjuhët tjera zyrtare të Kosovës.
2. Me vendim të Senatit dhe propozim të Këshillit të Fakultetit, ligjëratat mund të mbahen edhe në gjuhë të tjera.

### **Regjistrimi në vitin e parë të studimeve**

#### **Neni 11**

1. Kandidatët e interesuar për pranim dhe regjistrim në këtë fakultet duhet t'i plotësojnë këto kushte:
  - 1.1. Të kenë të përfunduar shkollën e mesme dhe të kenë kaluar provimin shtetëror të maturës;
  - 1.2. Të kenë kryer shkollën e mesme në Republikën e Kosovës;
  - 1.3. Të kenë përfunduar me sukses shkollën fillore dhe të mesme, më së paku 12 vjet të shkollimit;
  - 1.4. Të kenë të nostrifikuar dhe të vërtetuar diplomën e fituar të shkollimit të mesëm jashtë Republikës së Kosovës nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës.

### **Konkurimi për pranim në studime**

#### **Neni 12**

1. Konkurimi, pranimi dhe regjistrimi i studentëve të rinj, bëhet në pajtim me kushtet e parapara me konkursin, të cilin e shpall dhe e publikon Universiteti;
2. Kandidati fiton të drejtën për pranim dhe regjistrim kur e jep provimin pranues me sukses, duke u bazuar në numrin e pikëve të fituara sipas ranglistës deri në numrin e përcaktuar për pranim në programin, përkatësisht drejtimin përkatës mësimor.
3. Provimi pranues mbahet me test, nëse në konkurs nuk parashihet ndryshe.
4. Kushtet, afatet, organizimi dhe mënyra e mbajtjes së provimit pranues përcaktohen më detalisht në konkursin, të cilin e publikon Universiteti.

### **Ankesa për mospranim në studime**

#### **Neni 13**

1. Kandidati, i cili nuk e ka fituar të drejtën për regjistrim, ka të drejtë të paraqesë ankesë, të kërkojë sqarime dhe të shikojë testin e tij të dorëzuar për vlerësim.
2. Ankesa i paraqitet dekanit të Fakultetit në afat prej 24 orësh, nga dita e njoftimit, respektivisht nga dita e publikimit të rezultatit të mbajtjes së provimit pranues.
3. Dekani është i detyruar që ankesat e parashtruara t'i dorëzojë pa vonesë në Komisionin për Zgjidhjen e Ankesave të formuar nga rektori i Universitetit.



## **Dokumentet e nevojshme për pranim në studime**

### **Neni 14**

1. Kandidatët, të cilët konkurojnë në konkurs për pranim, janë të detyruar të paraqesin këto dokumente:
  - 1.1. Aplikimin online përmes web faqes së universitetit;
  - 1.2. Diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme në formë origjinale;
  - 1.3. Çertifikatën e lindjes;
  - 1.4. Kopjen e letërnjoftimit;
  - 1.5. Pagesën nga banka për provim pranues.
2. Dokumentacioni dorëzohet te zyrtaari për çështje të studentëve, nëse nuk parashihet ndryshe me konkurs.

## **Regjistrimi në studime**

### **Neni 15**

1. Kandidatët, të cilët e kanë fituar të drejtën për pranim dhe regjistrim, përveç dokumenteve të cekura më lartë, duhet të dorëzojnë edhe këto dokumente tjera plotësuese:
  - 1.1. Dëftesën e pagesës në emër të regjistrimit të semestrit;
  - 1.2. Formularin e plotësuar për regjistrim, i cili merret në fakultet.
2. Dokumentacioni plotësues dorëzohet te zyrtaari për çështje të studentëve brenda afateve të parapara ligjore.
3. Studenti regjistrohet në këtë fakultet me status të rregullt, nëse me konkurs për regjistrim nuk parashihet ndryshe.
4. Me rastin e regjistrimit, studentit i lëshohet kartela e identifikimit (ID).

## **Afati i regjistrimit të vitit akademik**

### **Neni 16**

1. Regjistrimi në vitin e parë të studimeve bëhet në kohën e përcaktuar me konkurs.
2. Regjistrimi në vitin e dytë dhe të tretë të studimeve, bëhet në kohën prej 1 deri më 15 tetor.
3. Vërtetimi i semestrave bëhet në kohën prej 15 deri më 20 janar për semestrin dimëror dhe prej 2 deri më 5 qershor për semestrin veror.

## **Vijueshmëria e mësimit nga studentët**

### **Neni 17**

1. Studenti i rregullt është i detyruar që të vijojë ligjëratat, ushtrimet, mësimin praktik, si dhe t'i kryej të gjitha detyrimet tjera që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e mësimit të përditshëm deri në përfundimin e studimeve.
2. Studenti, i cili nuk është i rregullt në ligjëratat dhe ushtrime, nuk ka të drejtë ta vërtetojë semestrin përkatës dhe as ta regjistrojë atë vijues.
3. Përrjashtimisht, studentit i lejohet të vërtetojë semestrin përkatës vetëm në raste të veçanta dhe të arsyeshme.
4. Vendimin nga paragrafi 3 i këtij neni e merr Dekani, pas kërkesës me shkrim nga studentit.

## **Kushtet për regjistrimin e vitit akademik**

### **Neni 18**

1. Studenti ka të drejtë të regjistrojë vitin e dytë të studimeve, nëse i ka fituar 70% të kredive apo provimeve nga numri i përgjithshëm i kredive nga lëndët mësimore të vitit të parë të studimeve.

2. Vitin e tretë të studimeve, studenti mund ta regjistrojë nëse ka fituar 40% të kredive apo provimeve nga numri i përgjithshëm i kredive nga lëndët mësimore të vitit të dytë të studimeve.
3. Vitin e katërt të studimeve, studenti e regjistron nëse ka fituar 30% të kredive nga numri i provimeve të vitit të tretë.

### **Përsëritja e vitit akademik**

#### **Neni 19**

1. Studenti ka të drejtë të përsërisë regjistrimin e vitit të njëjtë të studimeve sa dyfishi i kohëzgjatjes së studimeve.
2. Studenti, i cili në afatin e shtatorit nuk i fiton kreditë e parapara me anë të kësaj rregulloreje për regjistrimin e vitit vijues, e përsërit regjistrimin e vitit akademik.
3. Studenti, i cili përsërit regjistrimin e vitit të studimeve, paguan tarifën e shkollimit sikurse studentët tjerë të rregullt, respektivisht me korrespondencë.
4. Studenti mund të kërkojë edhe njëherë që t'i vazhdohet kohëzgjatja e studimeve të rregullta për një apo dy vite.
5. Vendimin definitiv për këtë e merr dekani i njësisë akademike.

### **Suspendimi i përkoshëm i statusit të studentit të rregullt**

#### **Neni 20**

1. Studenti mund të kërkojë suspendim të përkoshëm nga statusi i studentit të rregullt për këto raste:
  - 1.1. Sëmundjes së rëndë;
  - 1.2. Kujdesit për fëmijët nën moshën tri vjeçare; dhe
  - 1.3. Në rastet tjera të arsyeshme dhe justifikuara.
2. Vendimin lidhur me rastet e paragrafit 2 të këtij neni e merr Dekani pas kërkesës me shkrim të studentit.

### **Vazhdimi i studimeve të ndërprera**

#### **Neni 21**

1. Studenti, pas jo më tepër se dy vjet ndërprerjeje, mund të regjistrohet përsëri si student i rregullt dhe mund të vazhdojë në programin e njëjtë të studimit që ka qenë valid në kohën e regjistrimit të parë, edhe nëse në ndërkohë është ndryshuar programi i studimit.

### **Humbja e statusit të studentit të rregullt**

#### **Neni 22**

1. Studenti e humb statusin e rregullt në këto raste:
  - 1.1. Kur me dëshirën e vet i lëshon studimet;
  - 1.2. Kur t'i ketë përfunduar studimet;
  - 1.3. Kur nuk i ka përfunduar studimet në periudhën e dyfishtë të kohëzgjatjes së studimeve.
2. Rastet nga paragrafi 1 i këtij neni i evidenton Administrata e Fakultetit.

### **Ndërrimi i drejtimit të studimeve**

#### **Neni 23**

1. Studenti ka të drejtë të kërkojë ndërrimin e programit të studimeve në njësinë e njëjtë apo në njësinë tjetër akademike në pajtim me Statutin e Universitetit.
2. Studentit i lejohet ndërrimi i programit, nëse së paku 50% të provimeve janë dhënë me sukses në programin e mëparshëm e që pranohen në programin e ri të studimeve.

## **Procedura e ndërrimit të drejtimit të studimeve**

### **Neni 24**

1. Ndërrimi i drejtimit, lejohet vetëm në kohën prej 15 shtator deri më 30 shtator të vitit vijues.
2. Studentit mund t'i lejohet të regjistrohet në programin e ri të studimeve në vitin e dytë e tutje të studimeve në programe e drejtime përkatëse mësimore.
3. Pëlqimin nga paragrafi 2 i këtij neni, e jep Komisioni për Studime, ndërsa vendimin e merr Këshilli i Fakultetit.
4. Ndërrimi i programit të studimit nuk i lejohet studentit, i cili duhet sërish regjistrohet në vitin e parë të studimeve në programin e ri të studimeve.
5. Kërkesa për ndërrim të programit të studimeve apo drejtimit mësimor i paraqitet komisionit për studime të këtij fakulteti.
6. Krahas kërkesës, studenti paraqet edhe certifikatën e provimeve të dhëna të programit të mëparshëm.
7. Kundër vendimit të Komisionit për Studime, mund të paraqitet ankesë Këshillit të Fakultetit.
8. Ankesa paraqitet në afatin prej 8 ditësh nga dita e publikimit të vendimit të komisionit.

## **Kalimi nga fakultetet tjera**

### **Neni 25**

1. Studenti, i cili është regjistruar në fakultete të tjera, ka të drejtë të bëjë kalimin në njësi tjera akademike në pajtim me Statutin e Universitetit dhe nëse i plotëson kushtet sipas nenit 9 për programet (drejtimit) përkatëse.
2. Kalimi lejohet në kohën prej 1 deri më 15 tetor, përkatësisht prej 15 janar deri më 15 shkurt.
3. Nëse kandidatit i lejohet kalimi në drejtimin përkatës atëherë ai është i obliguar që për çdo provim të pranuar, si dhe lejimin e kalimit, të paguaj taksën në llogari të Universitetit, në bazë të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it.

## **Organizimi i provimeve**

### **Neni 26**

1. Provimet janë publike.
2. Provimet për studimet themelore mbahen në afatet dhe datat e përcaktuara dhe të publikuara në tabelën e njoftimeve.
3. Afatet e rregullta të provimeve janë:
  - 3.1. Afati i Janarit që fillon prej 20 Janar deri më 15 Shkurt;
  - 3.2. Afati i Qershorit që fillon prej 5 deri më 30 Qershor;
  - 3.3. Afati i Shtatorit që fillon prej 1 deri më 30 Shtator.

## **Publikimi i afateve të provimeve**

### **Neni 27**

1. Provimet e publikuara në tabelat e njoftimeve, janë detyruese, si për stafin akademik, ashtu edhe për administratën dhe studentin.
2. Orari i provimeve përcaktohet në atë mënyrë që studenti mos të ketë më shumë se një provim në ditë.
3. Orari i mbajtjes së provimeve shpallet në fillim të vitit akademik.
4. Dekani përpilon dhe publikon orarin e provimeve, pasi ti ketë marrë më parë datat e mbajtjes së provimeve nga shefat e programeve dhe drejtimeve përkatëse mësimore.

5. Ndryshimi i datës së mbajtjes së provimit lejohet vetëm në raste të arsyeshme nga Dekanati i Fakultetit.

### **Paraqitja e provimeve Neni 28**

1. Paraqitja e provimeve bëhet:
  - 1.1. Për afatin e janarit prej 15 deri më 20 Janar;
  - 1.2. Për afatin e qershorit prej 1 deri më 5 Qershor;
  - 1.3. Për afatin e shtatorit prej 20 deri më 30 Gusht.
2. Paraqitja e provimit me vonesë lejohet vetëm me kërkesë me shkrim të studentit dhe vendim të veçantë të Dekanatit.
3. Paraqitja e provimeve bëhet nga studentët me ID kartelë përmes sistemit SEMS, vetëm pas kryerjes së obligimeve administrative dhe financiare ndaj Universitetit.

### **Dorëzimi i rezultatit të provimit në administratë Neni 29**

1. Mësimdhënësi është i detyruar që pas përfundimit të provimit, më së largu brenda 5 ditëve, t'ia dorëzojë administratës raportin e provimeve, statistikën dhe fletëparaqitjet e shkarkuara nga sistemi SEMS.
2. Raporti i provimit, statistikën dhe fletëparaqitjet nga paragrafi 2 i këtij neni nënshkruhen dhe protokolohehen në Administratën e Fakultetit.

### **Forma e mbajtjes së provimit Neni 30**

1. Format e mbajtjes së provimit janë:
  - 1.1. Provimi me shkrim;
  - 1.2. Provimi me gojë;
  - 1.3. Provimi me shkrim dhe me gojë;
  - 1.4. Provimi me test;
  - 1.5. Provimi praktik;
  - 1.6. Kolokfiumi.
2. Provimet e kombinuara me shkrim dhe me gojë, mbahen brenda shtatë ditëve.

### **Notimi Neni 31**

1. Vlerësimi i provimit shprehet me këto nota:
  - 1.1. Nota 10 dhe 9, shpreh suksesin "Shkëlqyeshëm";
  - 1.2. Nota 8, shpreh suksesin "Shumë mirë";
  - 1.3. Nota 7, shpreh suksesin "Mirë";
  - 1.4. Nota 6, shpreh suksesin "Mjaftueshëm";
  - 1.5. Nota 5, shpreh suksesin "Pa mjaftueshëm" apo "Dobët";
2. Kandidati kalon provimin me sukses me notat 6 - 10.

### **Mënyra e vlerësimit të provimit Neni 32**

1. Provimet vlerësohen nga një pyetës ose me komision.

2. Provimet me komision mbahen:

- 2.1. Kur studenti është ankuar në vlerësimin e provimit të mbajtur;
- 2.2. Kur studenti i shtrohet provimit pas herës së tretë.

### **Ankesa për notim**

#### **Neni 33**

1. Studenti ka të drejtë të parashtrojë ankesë me shkrim dekanit të Fakultetit, kundër notës së marrë në provim, si dhe të kërkojë shikimin e testit të dorëzuar dhe të vlerësuar nga pyetësi apo nga Komisioni.
2. Ankesa duhet të parashtrohet brenda 48 orësh, pasi të jenë shpallur rezultatet e mbajtjes së provimit.

### **Komisioni për notim**

#### **Neni 34**

1. Dekani e cakton komisionin prej tre antarësh për mbajtjen e provimit.
2. Në komisionin e caktuar nuk merr pjesë pyetësi i mëparshëm.
3. Studenti nuk ka të drejtë të paraqesë ankesë kundër vlerësimit të komisionit.

### **Anulimi i provimit**

#### **Neni 35**

1. Provimi i dhënë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje anulohet.
2. Vendimin mbi anulimin e provimit e merr dekani.
3. Kundër këtij vendimi, studenti ka të drejtë ankesë.
4. Ankesa i paraqitet Këshillit të Fakultetit brenda 48 orësh nga dita e njoftimit për këtë.

### **Shtyrja e provimit**

#### **Neni 36**

1. Studenti ka të drejtë të kërkojë shtyerjen e mbajtjes së provimit, vetëm në rastet e arsyeshme dhe të justifikuara.
2. Vendimin për këtë e merr dekani, pas kërkesës me shkrim të studentit.

### **Të drejtat dhe detyrimet e studentëve**

#### **Neni 37**

1. Studentët kanë këto të drejta:
  - 1.1. Të marrin pjesë në të gjitha ligjëratat, ushtrimet teorike, ushtrimet laboratorike, mësim praktik, puna në terren, seminare, diskutime shkencore-mësimore, konsultime profesionale, ekskursione me karakter mësimoro-shkencor, si dhe në forma të tjera të mësimit që organizohen me plan e program mësimor;
  - 1.2. Të përdorin pajisjet e fakultetit, sipas rregullave përkatëse për mësim dhe ushtrime mësimore;
  - 1.3. Ta shfrytëzojnë bibliotekën e universitetit, në pajtim me rregullat përkatëse mbi punën e Bibliotekës;
  - 1.4. Të marrin pjesë në zgjedhjet e studentëve për përfaqësimin e tyre në organet e fakultetit;
  - 1.5. Të marrin pjesë në mbledhjet e organeve dhe të komisioneve ku janë caktuar si anëtarë dhe t'i kryejnë detyrat e tilla me angazhim dhe përgjegjësi;



1.6. Të kërkojnë të njihen me rregullat e përcaktuara mbi studimet themelore në këtë fakultet.

### **Shkeljet e obligimeve të studimeve**

#### **Neni 38**

1. Studenti, i cili nuk i përmbahet detyrimeve ligjore, statusore, si dhe rregullave dhe obligimeve të parapara me këtë rregullore apo me ndonjë vendim të veçantë të dekanit të Fakultetit gjatë tërë kohës së studimeve, bën shkelje të obligimeve të studimeve dhe për këtë përgjigjet në aspektin disiplinor dhe ligjor.

### **Ankesa për sheljen e të drejtave të studentëve**

#### **Neni 39**

1. Studentët kanë të drejtë të ankohen kundër çdo vendimi me të cilin konsiderojnë se iu kanë bërë shkelje të të drejtave të tyre gjatë kohës së studimeve.
2. Ankesa paraqitet:
  - 2.1. Kundër vendimit të dekanit, kur ka vendosur si organ i shkallës së parë – Këshillit të Fakultetit;
  - 2.2. Kundër vendimit të Komisionit për Studime, kur ka vendosur si organi i shkallës së parë-Komisionit për Ankesa të këtij fakulteti;
  - 2.3. Kundër vendimit të Këshillit të Fakultetit, kur ka vendosur si organ i shkallës së parë-Komisionit për studime të Universitetit.

### **Organizimi i studentëve**

#### **Neni 40**

1. Interesat e studentëve realizohen drejtpërsëdrejti në Këshillin e Studentëve dhe përmes përfaqësimit të tyre në:
  - 1.2. Këshillin e studentëve;
  - 1.3. Parlamentin e studentëve;
  - 1.4. Këshillin e fakultetit dhe;
  - 1.5. Senatin e Universitetit.
2. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre konform Statutit dhe rregullores në fuqi dhe në bazë të rezultatit të procesit zgjedhor.
3. Studentët kanë të drejtë të themelojnë organizata studentore, të cilave mund t'i përkasin të gjithë studentët.
4. Themelimi i organizatave studentore bëhet në pajtim me ligjet në fuqi, Statutin dhe rregulloret tjera të Universitetit.

### **Përfundimi i studimeve**

#### **Neni 41**

1. Studimet themelore 4 (katër) vjeçare përfundojnë pas dhënies së provimit të fundit.
2. Studenti, i cili me sukses e mbron provimin përfundimtar, fiton thirjen JURIST I DIPLOMUAR – BACHELOR.
3. Me rastin e diplomimit lëshohet certifikatë dhe diplomë origjinale.
4. Formën e certifikatës dhe të diplomës origjinale e përcakton me vendim të veçantë Universiteti, sipas Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës.
5. Diploma i dorëzohet studentit në mënyrë solemne.

6. Administrata e fakultetit mban evidencën e studentëve të diplomuar.

### **Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

#### **Neni 42**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Senati i Universitetit.
2. Për të gjitha çështjet e tjera, të cilat nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" dhe Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Kosovë, si dhe aktet e tjera normative.
3. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen në mënyrën në të cilën është miratuar kjo rregullore.



Rektori i përkohshëm

Prof. asoc. dr. Alush Musaj,